



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL
DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHËTETËSE

Tiranë, më 13.02.2023

NJOFTIM PUNËSIMI

Në zbatim të Vendimit nr. 877, datë 14.12.2016, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 719, datë 31.10.2014 të Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, si dhe në VKM nr. 56, datë 01.02.2023 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2023, në njësitë e qeverisjes qendrore”,

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural shpall njoftimin e punësimit për vendet e pa plotësuara si mëposhtë vijon :

I. DREJTORIA PËRZGJEDHJES DHE APROVIMIT TË PROJEKTEVE

➤ SEKTORI I PËRZGJEDHJES DHE APROVIMIT TË PROJEKTEVE IPARD, PËR MASËN 3, MASËN 4 DHE MASËN 7

SPECIALIST (me kontratë pune të përkohshme 6h/ditë), kategoria IV-b.

➤ Detyrat kryesore:

- Analizon nga ana administrative dosjet e aplikantëve për të aprovuar ose jo aplikimet e Masave 3, 4, 7, si dhe programeve të tjerë me financim të huaj, duke zbatuar Legjislacionin përkatës, Manualin e Procedurave dhe Udhëzimet përkatëse.
- Identifikon në mënyrë të vazhdueshme kërkesat/ankesat e deleguara nga eprori lidhur me aplikantët që kanë aplikuar në Masat 3, 4, 7, si dhe programeve të tjerë me financim të huaj.
- Asiston në përgatitjen, përditësimin e dokumentacionit për akreditim, trajnime dhe konsultime mbi përafrimin me standartet europiane në menaxhimin e fondeve.
- Kryen detyra të tjera të ngarkuara nga eprori përkatës.

➤ Kandidatët e interesuar duhet të përmbushin këto kritere:

1. Diplomë e nivelit “Master Profesional”, Shkenca Ekonomike/Shkenca Juridike/Shkenca Inxhinierike/Shkenca Agronomike/Akuakulturë/Hortikulturë/Mbrojtje Bimësh/Teknologji Agroushqimore/Bioteknologji Ushqimore/Mjekësi Veterinare. Edhe diploma Bachelor duhet të jetë në të njëjtën fushë. Diplomat e marra jashtë vendit duhet të jenë të njohura paraprakisht nga institucioni përgjegjës për njehësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
2. Të kenë aftësi shumë të mira komunikuese.
3. Të kenë njohuri bazë në përdorimin e kompjuterit

4. Të kenë njohuri bazë mbi zhvillimin bujqësor dhe rural në Shqipëri dhe mbi politikën e përbashkët për bujqësinë me BE-në.
5. Të kenë njohuri të gjuhës angleze.
6. Preferohet të kenë përvojë pune ose internshipi/praktika profesionale.

➤ **Kandidatët do të testohen në lidhje me:**

- Ligjin nr. 37, datë 09.04.2015, "Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II)";
- Ligjin nr. 30, datë 17.03.2016, "Për ratifikimin e marrëveshjes sektoriale ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian, që përcakton dispozitat e menaxhimit dhe zbatimit të asistencës financiare të Be-së për Republikën e Shqipërisë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit, në fushën "Bujqësia dhe Zhvillimi Rural" (IPARD)";
- Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike".

➤ **DREJTORIA E KONTROLLIT**

➤ **SEKTORI I KONTROLLIT TË SKEMAVE KOMBËTARE**

2 SPECIALIST (me kontratë pune të përkohshme 6h/ditë), kategoria IV-b

➤ **Detyrat kryesore:**

- Siguron marrjen në dorëzim dhe kontrollin fizik të dosjeve për Aplikimet e vlerësuara fituese nga komisionet e vlerësimit.
- Përgatit kryerjen e verifikimeve në terren të aplikimeve duke krahasuar rezultatet e faktit në terren me ato të aplikimit dhe duke i reflektuar në formularin e verifikimit.
- Analizon dhe verifikon rezultatet e kontrollit në formularin e verifikimit dhe në detyrat e tjera të ngarkuara nga drejtoria..
- Dorëzon dosjet së bashku me formularin e verifikimit pranë Agjencisë së Pagesave, në Drejtorinë e përcaktuar sipas Udhëzimit dhe Rregullores së Brendshme.

➤ **Kandidatët e interesuar duhet të përmbushin këto kritere:**

1. Diplomë e nivelit "Master Profesional" në Arsim i Lartë. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë. Diplomat e marra jashtë vendit duhet të jenë të njohura paraprakisht nga institucioni përgjegjës për njehësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
2. Të kenë aftësi shumë të mira komunikuese.
3. Të kenë njohuri bazë në përdorimin e kompjuterit

4. Të kenë njohuri bazë mbi zhvillimin bujqësor dhe rural në Shqipëri.
5. Preferohet të kenë përvojë pune ose internshipi/praktika profesionale.

➤ **Kandidatët do të testohen në lidhje me:**

- Ligjin nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”;
- Ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010, "Për kundërvajtjet administrative";
- Ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë brenda datës 16.02.2023, ora 16.30 në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (Adresa: Rruga “Muhamet Gjollesha”, Nr. 56, Tiranë): Kërkesën për punësim ku duhet të përcaktojnë pozicionin për të cilin po aplikojnë; një kopje të CV të përditësuar; diplomën e noterizuar; certifikata dhe kualifikime të ndryshme; një fotokopje e librezës së punës; një kopje të ID-së; formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore të firmosur nga aplikuesi; raportin mjeko-ligjor.

TË GJITHË KANDIDATËT QË APLIKOJNË PËR POZICIONET E MËSIPËRME, DO TË MARRIN INFORMACION VETËM NË FAQEN E INTERNETIT TË AZHBR www.azhbr.gov.al, PËR FAZAT E MËTEJSHME TË KËSAJ PROCEDURE:

- për rezultatet e verifikimit
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi (testim me shkrim/ intervista me gojë)
- shpalljen e listës së fituesve

Për të marrë këto informacione, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e internetit të AZHBR www.azhbr.gov.al.

AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL